



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 2946/6 Prot.

Koplik, më 12/12/2025

V E N D I M

Nr. 52, datë 11.12.2025

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës Financiare për familjen e Zotit Gjovalin Gjergj Gjinaj banesa e te cilit është djegur nga zjarri

Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe ne mbledhje e datës 11.12.2025 me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur ne Ligjin 139/2015“Per vetëqeverisjen vendore“, neni 54, shkronja“dh“,Ligjin 45 neni 30,41 pika 1,2,3, datë18.07.2019“Per Emërgjencat Civile“, VKM_së nr.329 date 16.05.2012 kreu III/I “Per kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“,Udhezimi i perbashkët i Ministrisë së Brendëshme dhe Ministrisë së Financave Nr.263,datë 224.05.2013 „Për kriteret dhe procedurat dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, VKB Nr.81..date 31.12.2024 Per miratimin e buxhetit të Vitit 2025.

V E N D O S I:

- 1-Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për ndihmen e menjëherëshme financiare familjes së z. **Gjovalin Gjergj Gjinaj** në vlerën **500.000** (pesëqindmijë) lekë, për djegjen e banesës së tijë nga zjarri.
- 2-Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin“**Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile**“, në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhë për **vitin 2025** të miratuar me VKB. .81..datë 31.12.2024 në programin_“Perballimi i ndihmave të menjëhershne për familjet në raste fatkeqesie“.
- 3-Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjorë të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për familjen e z. **Gjovalin Gjergj Gjinaj** në vlerën e dëmit nga ana ndertimore në shumen 2.009.872 (dy milionë e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, 50% i saj është **1.004.936** (një milion e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë,si dhe vlera e dëmit në paisje është **301.800** (treqind e një mijë e tetëqind.) lekë ku 50% i saj është **150.900** (njëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë. Sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Malësi

e Madhe. Vlera totale e dëmeve është **2.311.672** (dy milionë e treqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë ku 50% i saj është **1.155.836** (një milion e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

4- Ngarkohet administrata e bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumës prej **500.000** (peseqindë mijë) lekë.

5. Pjesa tjetër e vlers do të planifikohet për likuidim në buxhetin e vitit 2026 është 655.836 (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë lekë) si pasojë e fondeve të pa mjaftueshme për kompensim

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.

7. Ky vendim hyne në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit Nr. 139/2015 „ Për veteqeverisjen vendore“

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 11.12.2025

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me date 12.12.2025

